



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1805/1 prot.

Tiranë, më 13.11.2023

Lënda: Dhënie mendimi mbi projektvendimin

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 16868 prot., datë 07.11.2023, protokolluar me tonën nr. 1805 prot., datë 09.11.2023, me anë të së cilës dërgohet për mendim projektvendimi “Për Miratimin e Profilit të Zgjeruar Kombëtar të Migracionit për vitet 2019-2022”, dhe relacioni shoqërues.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së dokumentit, vërejmë se Profili i Zgjeruar Kombëtar i Migracionit për vitet 2019-2022, përmban të dhëna statistikore të marra nga burime zyrtare.

Megjithatë, në çdo rast Zyra e Komisionerit vlerëson se, ky dokument duhet të referojë edhe respektimin e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, së bashku me aktet nënligjore të cilët kanë për qëllim përcaktimin e rregullave për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale. Ky parashikim sugjerojmë të reflektohet në përmbajtjen e dokumentit dhe konkretisht në pjesën C.2.1 “Legjislacioni i brendshëm”.

Me reflektimin e sugjerimeve të mësipërme, Zyra e Komisionerit shprehet dakord me Projektvendimin.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

